



Pranuar / Dorëzuar Potholpeno / Pris. data Received / Delivery	08.11.2022	viti god Year	2
Organ / Baza Organ / Jedinstvo Org / Baza	Nr Prot Pr Prot Prot No	Shtojca Puteq Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHIC	6918/2022		15



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.620/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari- kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Beketshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit Anr.2457/2021 të datës 29.07.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.620/2021 të datës 08.07.2021 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës ", duke vepruar në pajtim me nenin 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 08.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.620/2021 e datës 08.07.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. SHFUQIZOHET Vendimi me numër A.nr.620/2021 i datës 16.09.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

III. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, në pajtim me legjislacionin në fuqi, të ndërmarr veprimet e nevojshme për harmonizimin e koeficientit të nëpunësit civil nga koeficienti pesë (5) në koeficientin gjashtë (6).

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesi me datë 22.09.2022 ka pranuar Vendimin me numër A.nr.620/2021 të datës 16.09.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollin 5473/2022, të cilit i është shqyrtuar ankesa e datës 08.07.2021 sipas Aktgjykimit Anr.2457/2021 të datës 29.07.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, duke u shpallur jo kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesit të datës 08.07.2021, i cili është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës sipas Akt emërimit të datës 07.03.2013 në pozitën "Depoist", në Qendrën Korrektuese në Dubravë, me koeficientin pesë (5).

Më datë 26.09.2022 ankuesi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të Vendimit me numër A.nr.620/2021 të datës 16.09.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet që të shfuqizohet vendimi i lartpërmendur dhe të aprovohet ankesa e datës 08.07.2021 ashtu siç është vepruar me rastin e kolegut të tij cili po ashtu ka qene ne pozitën „Depoist i Kuzhinës“ në Shërbimin Korrektues të Kosovës, të cilit Këshilli i ka aprovuar ankesën duke obliguar organin e punësimit që të beje harmonizimin e koeficientit nga 5 në koeficientin 6.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme, sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, **ka administruar këto prova:** Kërkesën e datës 26.09.2022 të parashtruar nga ankuesi për rishqyrtim të Vendimit me numër A.nr.620/2021 të datës 16.09.2022 të nxjerr nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimi Anr.2457/2021 i datës 29.07.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamentin për Çështje Administrative, i pranuar me datë 15.08.2022 me numër protokollin 4705/2022; Ankesën me numër protokollin 3566/2021 të datës 08.07.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimi i datës 19.10.2017; Akt emërimi i datës 07.03.2013; Konkurs i brendshëm i datës 03.07.2021; Njoftim i datës 03.07.2019; Përgjigje në ankesë, e datës 30.07.2021, e plotësuar me prova të lëndës me E-mailin e datës 02.08.2021; Lista e pagave nga data 01.06.2021 deri me date 30.06.2021; Njoftimi i datës 18.08.2021; Provat shtesë sipas E-mailit të datë 12.09.2022 të bashkangjitur dhe përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Depos; Njoftimin e datës 16.06.2021 mbi deklarimin e statusit të zyrtareve të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Akt Emërimi i datës 07.03.2013.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të të gjithave shkresave të bashkëngjitura në lëndë si dhe duke u bazuar në kërkesën e datës 26.09.2022 të ankuesit konstatoi se ankesa e ankuesit, është e bazuar, sepse:

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 16.09.2022 ka nxjerr Vendim A.nr.620/2021 përmes të cilit është shpallur jo kompetent për të vendosur për ankesën e datës 08.07.2021 të ankuesit, ndërsa më datë 26.09.2022 ankuesi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të Vendimit me numër A.nr.620/2021 të datës 16.09.2022 të Këshillit të Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet që te shfuqizohet vendimi i lartpërmendur dhe të aprovohet ankesa e datës 08.07.2021 ashtu siç është vepruar me rastin e kolegut të tij [] i cili po ashtu ka qenë në pozitën Depoist i Kuzhinës në Shërbimin Korrektues të Kosovës, të cilit Këshilli i ka aprovuar ankesën duke obliguar organin e punësimit që te beje harmonizimin e koeficientit nga 5 në koeficientin 6, duke bashkangjitur dhe Akt emërimin e nëpunësit

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit sipas kërkesës të datës 26.09.2022 për rishqyrtim te Vendimit të Këshillit, ka konstatuar se në rastin konkret gjate administrimit te provave në Vendimin me numër A.nr.620/2021 të datës 16.09.2022 të nxjerr nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji nuk ka pasur dëshmi gjegjësisht Zyra e personelit e SHKK –së nuk ka dërguar listën e miratuar nga Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për deklarin e statusit të zyrtarëve publik në Shërbimin Korrektues të Kosoreve edhe pse kjo prove apo dëshmi është kërkuar nga Këshilli përmes e-mailit te datës 12 shtator 2022, dhe për këtë arsye Kolegji ne arsyetimin e vendimit te lartcekur ka theksuar se, „ Kolegji vlerëson se përderisa nuk kemi ndonjë akt administrativ nga organi kompetentë që ka vendosë në lidhje me deklarin e statusit të zyrtarëve publik të kësaj kategorie dhe mbi bazë të përshkrimit të detyrave të punës të njëjtit llogariten Nëpunës administrativoo-teknik dhe mbështetës, andaj Kolegji duke i'u referuar Njoftimit të datës 16.06.2021 mbi deklarin e statusit të zyrtareve publike në Shërbimin Korrektues të Kosovës të dërguar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme ka konstatuar se pozita e ankuesit „Zyrtar i Depos“ me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë është kategorizuar si nëpunës i shërbimit civil, dhe ka vendosur se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar ankesat e „Zyrtareve të Depos“ të punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës në këtë rast edhe të ankuesit.

Kolegji duke marr për bazë faktet e lartpërmendura si dhe duke u bazuar ne Vendimin me numër A.nr.619/2021 të datës 18.08.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me te cilin vendim është vendosur meritorisht për rastin e ankuesit [] ku natyra e ankesës dhe gjendja faktike në ankesën e parashtruar nga ankuesi [] ka qene e njëjtë, andaj Kolegji duke u bazuar në nenin 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ, ka vendosur për shfuqizimin e Vendimit me numër A.nr.620/2021 të datës 16.09.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe shqyrtimin dhe vendosjen në mënyrë meritore për rastin e ankuesit

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet e ankuesit sipas kërkesës së datës 26.09.2022 si dhe duke u bazuar ne shkresat e lendes ka konstatuar se Shërbimi Korrektues i Kosovës gjate vitit 2019 me datë 03.07.2019 ka shpallur konkursin e brendshëm për pozitën „ Zyrtar i Depos“, në Qendrën Korrektuese në Lipjan, në të cilin konkurs për këtë pozitë është paraparë koeficienti gjashtë (6), po ashtu në shkresat e lëndës kemi edhe Akt emërimin e datës 19.10.2017 të Zyrtarit të Depos, gjegjësisht nëpunësit Z.S i punësuar në Burgun e Sigurisë së Lartë në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës me koeficient gjashtë (6).

Kolegji i Këshillit, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave si dhe nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil me të cilin parashihet se: 1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara më këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë....*, e si rrjedhojë Kolegji ka konstatuar se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësit civil të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës dhe që kanë kualifikime dhe përvojën e kërkuar për pozitën respektive, duhet të realizojnë pagë të njëjtë. Andaj, në vështrim të këtyre dispozitave si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji meqenëse ka gjetur se organi i punësimit nuk ka unifikim të pagës për Zyrtar të Depos pasi aplikohen koeficient të ndryshëm lidhur me këto pozita për kategori të njëjtë, kështu që bazuar në këto fakte dhe konstatime, Kolegji i Këshillit vlerëson se aplikimi i koeficienteve jo të njëjtë të pagës për pozita të kategorive të njëjta, paraqet trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të stafit ashtu siç është përcaktuar me nenin 4 paragrafi 1 Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi ku thuhet se: *"Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, dhe se trajtimi jo i barabartë i të punësuarve të së njëjtës kategori brenda të njëjtit institucion është në kundërshtim të plotë edhe me nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.*

Andaj, nisur nga gjendja faktike dhe juridike e konstatuar si me lartë, Kolegji vlerësoj se organi i punësimit gjegjësisht Shërbimi Korrektues i Kosovës me rastin e mos harmonizim të koeficientit të pagës së ankuesit ka vepruar edhe kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me të cilin është përcaktuar se: *Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë, kështu që Kolegji vlerëson se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit mbi bazën e harmonizimit të koeficientit të pagës me zyrtarët e tjerë të kategorisë së njëjtë.*

Mbi bazë të këtyre, Kolegji i Këshillit, konstaton se Drejtori i Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës, është i obliguar që të ndër marr veprime konform këtij vendimi që të bëjë harmonizimin e koeficientit për ankuesin nga koeficienti pesë (5) në koeficientin gjashtë (6).

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.620/2021.

Zyle Millaku GOJNOVCI


Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.